VENDIM
Nr.105, datë 23.1.2013

PËR SHPËRBLIMIN E PRONARËVE MBI SIPËRFAQET TAKUESE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15/1 e 32, pika 1 të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e pronarëve mbi sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, të zëna nga ndërtimet informale në qarqet Shkodër, Durrës, Vlorë, Elbasan Berat dhe Tiranë.

Pronarët e pasurive të paluajtshme, për sipërfaqen e zënë nga ndërtimet informale, të shpërblehen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 8 687 (tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë) m² tokë truall, me vlerë të përgjithshme: 103 796 372,4 (njëqind e tre milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy, presje katër) lekë.

2. Vlera e përgjithshme e shpërblimit të përballohet nga fondi i kompesimit të pronave, të parashikuar nga ligji nr. 10 239, datë 25.10.2010 "Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave", të ndryshuar.

3. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me këtë vendim, të kryejë ndryshimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, për kalimin e pasurisë së paluajtshme të kompesuar, në pronësi të shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Agjencia e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha